



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE**  
**KORÇE**

Nr. (239)-00002 Regj. Them  
Data e Regj:05.01.2016

Nr.441 (171) Vendimi  
Data:29.04.2016

**V E N D I M**

**NE EMER TE REPUBLIKES**

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Korçe e perbere nga:

**SOKOL IBI - Gjyqtar**

Asistuar prej sekretares Viola Palla, pasi shqyrtoi ne seance gjyquesore publike, sot me date 29.04.2016. ne Korce, çeshtjen administrative me Nr.(239)00002 Regj.Them, qe i perket paleve ndergjyqese:

**PADITES:** “Albmiri” sh.p.k-me seli ne Korce, e perfaqesuar ne gjykim nga Administratori Ermir Skenderi (ne mungese).

**I PADITUR:** Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Mirela Veriga.

**OBJEKTI:** Shfuqizimin i njostim vleresimit per detyrimet tatimore Nr.6209 Prot, date 25.07.2012 si akt absolutisht i pavlefsphem.

**BAZA LIGJORE:** K.Pr.Administrative neni 1:16/c, neni 17/a i ligjit Nr. 49/2012, ligji Nr.10279, date 20.05.2010, ligji Nr.9920, date 19.05.2008.

Ne perfundim te gjykit, gjykata pasi shqyrtoi provat ne teresi, me konkluzionet perfundimitare pala paditese perfundimisht kerkoi pranimin e padise, pala e paditur perfundimisht kerkoi rrezimin e padise,

## VEREN

Se pala paditese ka paraqitur para kesaj gjykate padine me objektin e sipercituar.

### Faktet e ceshtjes.

Paditesi "Albmiri" sh.p.k eshte person juridik privat qe e ushtron veprimitarne e tij tregetare ne qytetin e Korces midis te tjerave edhe ne fushen e tregetimit te karburanteve, sikurse rezulton nga ekstrakti i QKR-se per palen paditese.

Ne daten 17.07.2012 punonjesit e pales se paditur kane kryer nje kontroll ne ambjentet ku ushtron aktivitetin e saj tregetar pala paditese ne qytetin e Korces ne rugen nationale Korce-Pogradec.

Punonjesit e pales se paditur kane konstatuar se ne ambjentet ku ushtron aktivitetin e saj tregetar pala paditese ishin tre punonjes te pasiguruar te cilet nuk kane pranuar te identifikohen.

Punonjesit e pales se paditur kane hartuar ne vend procesverbalin e konstatimit te kundravajtjes administrative te dates 17.02.2012 dhe ne fund te tij kane vodosur shenimin se kundravajtesi refuzon te firmose.

Punonjesit e pales se paditur kane hartuar ne vend procesverbalin e gjobes te dates 17.07.2012 ku kane vodosur denimin me gjobe ne masen e 300.000 lekeve te pales paditese per kryerjen e kundravajtjes administrative te parashikuar nga nenii 119, pika 1, germa "a" te ligjit Nr.9920/2008, per arsyte se nuk ka deklaruar ne organin tatimor tre punojes te pasiguruar.

Ne fund te ketij procesverbali eshte vodosur shenimi se tatimpaguesi refuzon te nenshkruaje.

Me shkresen Nr.6209 Prot, date 25.07.2012 te Drejtorese Rajonale Tatimore Korce te titulluar "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" njoftohet pala paditese per detyrimin e saj per te paguar shumen prej 300.000 lekesh si gjobe te vodosur sa me siper u pershkrua.

Pala paditese pretendon se nuk eshte vene asnjehere ne dijeni nga pala e paditur per gjoben e vendosur ndaj tij dhe kete fakt e ka marre vesh ne daten 01.09.2015 kur eshte njoftuar nga punonjesit e borxhit te pales se paditur.

Po ne kete kohe pretendon pala paditese jam vene ne dijeni nga punonjesit e pales se padiur per procesverbalin e konstatimit te kundravajtjes administrative dhe per vendimin e denimit me gjobe.

Pala paditese pretendon se akti administrativ "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore Nr.6209 Prot, date 25.07.2012 eshte nje akt administrativ absolutisht i pavlefshem, sepse eshte nxjerre nga organi administrativ ne kundershtim me formen dhe proceduren e parashikuar nga ligji.

Ky akt administrativ pretendon pala paditese duhej te me ishte derguar me poste rekomande ne baze te nenit 69 te ligjit Nr.9920/2008, gje qe nuk ka ndodhur ne rastin konkret.

Ne asnje moment nuk eshte mbajtur ne ambjentet ku ushtoj aktivitetin tregetar nje procesverbal konstatimi kundravajtje dhe vendim denimi me gjobe, por keto akte jane mbajtur ne zyrat e pales se paditur.

Paditesi pretendon se pala e paditur ka shkelur te drejten e tij per tu degjuar gjate kesaj procedure administrative dhe perpara marrjes se vendimit te denimit me gjobe e nxjerrjes se njoftim vleresimit tatimor, e drekte kjo e parashikuar nga nen 37 i ligjit Nr.9920/2008.

Pala e paditur ka prapesuar duke pretenduar se ky inspektim eshte kryer ne baze te nenit 80 te ligjit Nr.9920/2008.

Inspektoret e pales se paditur e kane ushtruar kete kontroll bazuar ne urdherin e punes dhe kane konstatuar se paditesi kishte tre punonjes te padekluar ne organin tatimor dhe te pasiguruuar.

Pala e paditur prapeson duke pretenduar se nuk jemi para asnjerit prej rasteve te pavlefshmerise absolute te nje akti administrativ.

Dispozitat ligjore te zbatueshme.

Kodi i Procedures Administrative

Neni i 16 Aktet administrative absolutisht të pavlefshme.

*Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme: a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar; b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore; c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.*

Ligji nr.9920/2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise"

Neni 37 E drejta për t'u dëgjuar.

*"Tatimpaguesi, përpara marrjes së një vendimi administrativ për të dhe pasurinë e tij, ka të drejtën të dëgjohet nga administrata tatimore".*

Neni 80 Kontrolli tatimor

*5. Kontrollet, që kryhen nga administrata tatimore qendrore, urdhërohen nga drejtori i drejtorisë rajonale të tatimeve apo drejtuesit e njësive të ngashme me të. Kontrollet, që kryhen nga administrata tatimore vendore, urdhërohen nga titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore*

#### Vleresimi i gjykates.

Gjykata çmon se gjate kryerjes se kontrollit nga inspektoret e pales se paditur ne ambjentet ku ushtron aktivitet tregetar pala paditese jane kryer shkelje proceduriale si me poshte:

Se pari. Kontrollin tatimor te kryer ne ambjentet e pales paditese nga inspektoret e pales se paditur duhet ta kishte urdheruar Drejtori i Drejtorise Rajonale Tatimore Korce, ne baze te nje urdheri pune te dhene inspektoreve tatimore qe do te kryenin kontrollin. Ky urdher pune duhej ti ishte njoftuar ne vend perfaqesuesit te pales paditese pavaresisht llojit te kontrollit.

Nga permbajtja e procesverbalit te konstatimit te kundravajtjes administrative dhe vendimit te denimit me gjobe nuk rezulton qe ky kontroll te jetë kryer ne baze te nje urdheri kontrolli te dhene nda titullari i pales paditur. Kjo do te thote se kontrolli i kryer nga inspektoret e pales se paditur vjen ne kundershtim me nenin 80/5 te ligjit Nr.9920/2008.

Se dyti. Gjykata çmon se ne baze te nenit 37 te ligjit Nr.9920/2008 pala e paditur ka detyrimin per te rrespektuar te drejten per tu degjuar te pales paditese

perpara çdo vendimarrje administrative te administrates tatimore qe ka lidhje me pasurine e pales paditese.

Ne te tilla rrrethana pala e paditur kishte detyrimin te degjonte palen paditese perpara nxjerrjes se aktit administrativ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore objekt kundershtimi ne kete gjykim, sepse nepermjet ketij akti administrativ, administrata tatimore ka marre vendim per te detyruar palen paditese te paguaje gjoben ne masen e 300.000 (treqind mijë) lekeve per kundravajten administrative te pretenduar te kryer nga pala paditese.

Ne rastin konkret nuk rezulton qe pala e paditur ta kete degjuar palen paditese perpara nxjerrjes se njoftim vleresimit per detyrime tatimore. Pra pala paditese nuk rezulton te jete degjuar nga administrata tatimore per pretendimet e saj rreth shkeljes administrative te pretenduar se ka kryer mosdeklarimin e tre punonjesve ne organin tatimor.

Keto shkelje proceduriale e pales se paditur ne nxjerrjen e aktit administrativ njoftim vleresimi per detyrime tatimore ndikojne ne vlefshmerine e ketij akti administrativ dhe kjo eshte arsyaja pse ky akt administrativ eshte absolutisht i pavlefshem ne kuptim te nenit 116/c te K.Pr.Administrative, padi eshte nxjerre ne kundershtim me proceduren e parashikuari nga ligji Nr.9920/2008.

Per keto arsye pretendimet e pales paditese se ky akt administrativ eshte absolutisht i pavlefshem jane pretendime te bazuara ne prova dhe ne ligj.

Per keto arsye padia e paditesit eshte e bazuar ne prova dhe ne ligj dhe si e tille ajo duhet pranuar nga gjykata.

Ne baze te nenit 45 te ligjit Nr. 49, date 03.05.2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykin e Mosmarrveshjeve Administrative", ndaj ketij vendimi nuk lejohet ankim, sepse objekt kerkimi eshte kundershtimi i akteve administrative qe permabajne detyrime ne te holla me vlere me te vogel se njezetefishi i pages minimale ne shkalle vendi. Paga minimale ne shkalle vendi me baze te V.K.M Nr.573, date 03.07.2013 eshte ne masen 22.000 leke, ndersa njezetefishi i saj eshte i barabarte me 440.000 leke

#### **PER KETO ARSYE**

Gjykata ne baze te neneve 40, 41, 45 te ligjit Nr.49, date 03.05.2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative"

VENDOSI

1. Pranimin e padise.
  2. Konstatimin e pavlefshmerise absolute te aktit administrativ "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" Nr.6209, date 25.07.2012, te Drejtorese Rajonale Tatimore Korce.
  3. Shpenzimet gjyqesore jane ne ngarkim te pales se paditur. Ky detyrim duhet te permbushet nga debitori pale e paditur ne gjykim, pas marrjes forme te prere te ketij vendimi, duke derdhur ne llogarine bankare te kreditorit padites ne kete gjykim shumen perkatese monetare dhe eshte nje detyrim i ekzekutueshem nga permbaruesi gjyqesor.  
- Kunder ketij vendimi nuk lejohet ankim.
- U shpall sot me date 29.04.2016 ne Korçe.

SEKRETARE

VIOLA PALLA

GJYQTAR

SOKOL IBI

Shpenzimet gjyqesore:

1. Takse pulle 3.000 leke;  
Totali 3.000 leke (te parapaguara nga paditesi).

VERTETOHET  
N J E S I A  
ME ORIGJINALIN  
KANCELAR  
ALEKSANDER DINO

